

COLORFIS

ASTAR MURI I MIKRONIZUAR, MBULUES PËR SIPËRFAQE TË JASHTME DHE TË BRENDSHME
SERI 476

PËRSHKRIMI

COLORFIS është astar i hollueshëm me ujë me penetrim të lartë, për mbushjen dhe izolimin e sipërfaqeve murale të brendshme dhe të jashtme, i përshtatshëm si sfond mbulues për bojrat me bazë uji, veçanërisht për ngjyra intense/të errëta.

Lidhësit e veçantë, frut i nanoteknologjisë, i sigurojnë produktit që të ngeli transparent kur është i njome, por të bëhet mbulues kur thahet. Produkti evidenton praninë e mbetjes se lageshtires se larte ne siperfaqe duke mos mbuluar.

COLORFIS përmirëson kohezionin dhe uniformon absorbimin e sipërfaqes, duke krijuar vendosjen ideale për shtresat pasardhëse. Produkti mund të pigmentoset lehtësisht nëpërmjet sistemit tintometrik; përdorimi i COLORFIS të ngjyrosur siguron përfundimin e mbulimit të shkëlqyer në cikle të ljerjes me bojë të lashme në tonalitete të errëta dhe me gjallëri.

ISTRUKSIONE PËR PËRDORIM

I aplikueshëm në:

- Suva të reja dhe të vjetra me bazë lidhës hidraulikë.
 - Sipërfaqe betoni.
 - Sipërfaqe gipsi dhe kartonxhesi.
 - Bojra të vjetra dhe veshje me natyrë organike ose minerale të thata, kompakte, absorbuese dhe kohezive.
 - Konglomerate me natyrë të ndryshme minerale me kusht që të jenë absorbuese.
- Sipërfaqet përgatiten sipas shpjegimit në paragrafin **"Përgatitja e sipërfaqes"**.

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

- Natyra e Lidhësit: nanopolimerë akrilikë në dispersion ujor
- Solventi: ujë
- Dendësia UNI EN ISO 2811-1: 1,15-1,25 kg/l
- Tharja (25 °C dhe 65% U.R.): prekja pas 30-40 min.; shtresa tjetër pas 2 orësh.

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

- Sipërfaqe në suva, gips dhe kartonxhes:
- Sigurohuni që sipërfaqja të ketë një kohë maturimi prej të paktën 28 ditësh.
- Kontrolloni gjendjen e sipërfaqes. Duhet të jetë e qëndrueshme. Nëse është nevoja siguroni konsolidim me produkte specifike.
- Në prani të mykut trajtoni sipërfaqen me detergjentin COMBAT 222 kod. 4810222 dhe

me detergjentin COMBAT 333 kod. 4810333 (I cili penetron në brendësi/thellësi të sipërfaqes).

- Hiqni, me zmerilim ose me ujë me presion mesatar, ndotjet e pranishme.
- Në prani të bojrave të vjetra, hiqni pjesët e cimentosura dhe jo të mirë aderuar, ndërsa shtresat e ngritura të bojrave në gëlqere ose temperave duhet të hiqen tërësisht duke e larë sipërfaqen me ujë të bollshëm ose me makineri pastrimi.
- Niveloni parregullsitë e sipërfaqes dhe trajtoni vrimat, gropëzat, çarjet me TAMSTUCCO 9400006 ose TAMSTUCCO POLVERE 9410110 ose STUCCOFACILE 9560019; Zmeriloni çarjet e stukuara me letër zmerile.
- Mbyllni çarjet me ngjitës (stuko) të përshtatshëm.
- Kryeni zbutje në sipërfaqe me RASAMIX 9440160 ose me BETOMARC 9450150 ose me RASOMARC 9500150 sipas llojit të sipërfaqes.
- Hiqni smogun, pluhurat dhe çdo ndotje tjetër me zmerilim
- Në prani të sipërfaqeve me ndotje/pluhur aplikoni një shtresë astar të mikronizuar solvent free ATOMO 8840001.
- Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e tharë mirë dhe aplikoni COLORFIS sipas metodave të përshkruara në udhëzimet për aplikim.
- Pas të paktën 2 orësh vazhdoni me aplikimin e produktit të finiturës.

Sipërfaqe betoni:

- Shpatulloni sipërfaqen dhe eliminoni shtresat e vjetra të bojës në fazën e rënies.
- Në prani të mykut trajtoni sipërfaqen me detergjentin COMBAT 222 kod. 4810222 dhe me detergjentin COMBAT 333 kod. 4810333 (I cili penetron në brendësi/thellësi të sipërfaqes).
- Hiqni pjesët e strukturës së çimentos që nuk janë të aderuar.
- Shufrat metalike të armaturës në sipërfaqe duhet të pastrohen/zmerilohen dhe të trajtohen me BETOXAN PRIMER 9490125 Boiaccia passivante.
- Rivendosni pjesët që mungojnë me zbutësin BETOXAN 400 ose BETOXAN 300 llaç tiksotropik anti-tkurrje me fibra të përforcuara 9490140/130; kryeni ngjitjen përfundimtare me anti-karbonatizuesin anti-tkurrje BETOXAN 200 9490120.
- Në prani të sipërfaqeve me ndotje/pluhur aplikoni një shtresë astar të mikronizuar solvent free ATOMO 8840001

COLORFIS

ASTAR MURI I MIKRONIZUAR, MBULUES PËR SIPËRFAQE TË JASHTME DHE TË BRENDSHME
SERI 476

-Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e tharë mirë dhe aplikoni COLORFIS sipas metodave të përshkruara në udhëzimet për aplikim.
-Pas të paktën 2 orësh vazhdoni me aplikimin e produktit të finiturës.

UDHËZIME PËR APLIKIM

-Kushtet e ambientit dhe të sipërfaqes:
Temperatura e ambientit: Min. +8 °C / Max. +35 °C

Lagështira relative e ambientit: <75%
Temperatura e sipërfaqes: Min. +5 °C / Max. +35 °C

Lagështira e sipërfaqes: <10%

-Shmangni aplikimet në sipërfaqe që janë në ndikimin e drejtpërdrejtë të diellit ose me kondensim.

-Mjetet: pinel, rrul.

-Nr i shtresave: aplikohen 1-2 shtresa e njomë mbi e njomë.

-Hollimi: nga 10 në 25% me ujë sipas absorbimit të sipërfaqes.

-Pastrimi i mjeteve bëhet menjëherë pas përdorimit, me ujë.

-Shkalla e mbulimit: 8-10 m²/l për shtresë. Është mirë që të përcaktohet rrezja efektive me një provë paraprake në sipërfaqe specifike.

NGJYROSJA

Ngjyrosja është e mundur nëpërmjet Sistemit Tintometrik Marcromie.

Produkti, për më tepër, është i ngjyreshëm me kolorantët COLORADO seri 548 deri në një maksimum 5%.

Në rastin e ngjyrave të errëta, ngjyrosni COLORFIS me të njëjtën ngjyrë të finiturës, aplikoni produktin dhe vazhdoni më pas me dy shtresat e finiturës.

MAGAZINIMI

Temperatura maksimale e ruajtjes: +30 °C

Temperatura minimale e ruajtjes: +5 °C

Produkti preferohet të përdoret brenda 2 vitesh nga data e prodhimit, nëse është ruajtur në ambalazh origjinal të pahapur dhe në kushte në temperaturë të përshtatshme.

UDHËZIME SIGURIMI

Vlera limite BE (Dir. 2004/42/EC)

Cat. H: astar (bazë uji): 30 g/l (2010)

COLORFIS Përmban max: 30 g/l VOC

Produkti nuk kërkon etiketim sipas D.L. 65 te 14/03/03 dhe modifikimeve/ azhornimeve.

Përdoreni produktin sipas normave aktuale të

higjienës dhe sigurisë; pas përdorimit mos l hidhni mbetjet në ambient l lini të thahen dhe l trajtoni ato si mbetje të veçanta. Mbajeni larg përdorimit nga fëmijët. Përdoreni në vende të mirë ventiluara. Për më shumë informacion konsultohuni me skedën e sigurisë.

SPECIFIKIMET

Astar muri mbulues për sipërfaqe të jashtme dhe të brendshme.

Aplikimi, në sipërfaqe të predispozuara, për astar muri me bazë uji COLORFIS kod.

4760001, me bazë nanopolimerë akrilikë, i përshtatshëm për mbushjen e sipërfaqeve të murit në sasinë e caktuar nga absorbimi i sipërfaqes.

Furnizimi dhe instalimi i materialit € për m².

SAN MARCO GROUP garanton që informacionet e kësaj skede janë marrë nga eksperiencia e saj dhe nga njohjet e saj teknike dhe shkencore; megjithatë nuk mund të mbajë asnjë përgjegjësi për rezultatet e arritura duke qenë se kushtet e aplikimit janë jashtë kontrollit të saj. Këshillohet të verifikohet gjithmonë efikasiteti i produktit. Skeda e paraqitur anulon dhe zëvendëson çdo skedë të mëparshme. Për informacione të mëtejshme teknike kontaktoni në nr.pa pagesë të Asistencës Teknike 800853048.